



Pranuar / Dorezuar Prijmen / Podato Received / Delivered	20.12.2023	3	viti god year
Organ / Jesta Org / Jst	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSTICA	7588	2023	1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1323/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1275/2023 të datës 12.10.2023 të parashtruar nga _____, dhe ankesës me numër A.nr.1323/2023 të datë 24.10.2023 të parashtruar nga _____, të bashkuara sipas Vendimit me numër protokolli 7087/2023 të datës 14.11.2023 në një procedurë të vetme nën shenjen A.nr.1323/2023, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1323/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankueset _____.
- II. Anulohet Vendimi Nr.1405 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror, Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarrë nga faza e verifikimit paraprak deri në publikimin e Njoftimit të datës 12.09.2023, ndërsa, çështja kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.
- III. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi sikurse është përcaktuar si në pikën II të këtij dispozitivi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Arsy e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 05.05.2023, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit, respektivisht në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) ka publikuar Konkursin për grupin "Specialit i Arsimit" me numër reference RN00011607, gjegjësisht pozitën e punës "Inspektor i Arsimit" SIA-Prizren, tri (3) pozita, ku afati i aplikimit ishte nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023. Si rrjedhojë nga shkresat e lëndës rezultoi se në këtë konkurs ka aplikuar edhe kandidatja _____, dhe _____ (në tekstin e mëtejshme: Ankueset) por që të njëjtat nuk kanë arritur të jenë në mesin e kandidatëve fitues të cilët janë rekomanduar për emërim në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankueset, me datë 12.10.2023, respektivisht me datë 24.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është përcjell me shkelje të dispozitave ligjore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës se anëtarëve të Kolegji të Këshillit, dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, me datë 24.11.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 7087/2023 me të cilin ka bashkuar procedurën për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.1257/2023 të datës 12.10.2023 të parashtruar nga _____ dhe ankesës me numër A.nr.1323/2023 të datë 24.10.2023 të parashtruar nga _____ duke u regjistruar kështu si një ankesë e vetme nën shenjen e ankesës së fundit me numër A.nr.1323/2023 të datë 24.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër A.nr.1257/2023 të datës 12.10.2023 të parashtruar nga _____; Ankesën me numër A.nr.1323/2023 të datë 24.10.2023 të parashtruar nga _____;

Konkursin për grupin "Specialit i Arsimit" me numër reference RN00011607, pozitën "Inspektor i Arsimit" SIA-Prizren; Vendimin Nr.1405 të datës 11.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror; Njoftimin e datës 12.09.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues; Dosjen e kandidateve fitues; E-mailin e datës 17.11.2023 të Zyrtareve përgjegjës të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 24.10.2023, respektivisht 29.11.2023, si dhe dokumentacionin tjetër përcjellës mbi procedurën e zhvilluar.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa është e bazuar dhe se lënda ku ankueset janë palë në procedurë, duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, *sepse*:

Kolegji i Këshillit, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ndërlidhur me plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit, nga kandidatët në procedurë, ka analizuar Konkursin me numër të referencës: RN00011607 për grupin "Specialistë të Arsimit", klasa e pozitës, Profesional 1, pozita e punës "Inspektor i Arsimit" në SIA-Prizren, dhe si rrjedhojë ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale, të përcaktuara në konkursin përkatës, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;*
- *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës me theks të veçantë përvojë pune në mësimdhënie.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht Njoftimit të datës 12.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutit dhe Inspektimit në DMZP/MPB, ka gjetur se tre (3)

kandidatë fitues, me më se shumti pikë, për grupin "Specialistë të Arsimit" pozita "Inspektor i Arsimit në SIA-Prizren", janë: 1. _____ me gjithsejtë 89.6 pikë, 2. _____ me gjithsejtë 87.8 pikë, dhe 3. _____ e gjithsejtë 83.3 pikë.

Kolegji i Këshillit, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi dosjen e tre (3) kandidateve fitues të cilët kanë mbledhur më se shumti pikë dhe rrjedhimisht janë rekomanduar për emërim në shërbimin civil, dhe si rrjedhojë konstatoi se: 1. Kandidatit

1 - me rastin e aplikimit ka dorëzuar Vendimin Nr.22/2009 të datës 21.01.2009 të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përmes të cilit të njëjtit i njihet grada universitare "Jurist i Diplomuar" e fituar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, si dhe Diplomën me Nr.805 të datës 12.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes të cilës dëshmohet se, me 11 shkurt 2015 ka përfunduar Studimet Master në Universitetin e Prishtinës - Fakultetin Juridik, në drejtimin Kushtetues-Administrativ. Ndërsa, sipas shkresave të administruara të lëndës, rezulton se i njëjti nuk ka Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar sikurse përcaktohet me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, dhe nuk posedon përvojë pune në mësimdhënie sikurse është kërkuar në konkurs. 2. Kandidatja _____ me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr.545 të datës 12.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës vërtetohet se më datë 27.05.2005 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Dega e Kimisë, duke fituar kështu titullin "Profesor i Kimisë" si dhe Diplomën me Nr.180 të datës 22 gushtë 2011 të lëshuar po ashtu nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, drejtimi Kimi Organike dhe Biokimi, duke fituar kështu titullin Master i Shkencave të Kimisë. Po ashtu, me rastin e aplikimit e njëjta ka dorëzuar Licencën e Mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me afat vlefshmërie nga data 26.12.2012 deri më datë 26.12.2017. 3. Kandidati tjetër fitues,

_____ me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr.1063 të datës 15 korrik 1014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën vërtetohet se, me datë 19 mars 2014 ka përfunduar Fakultetin e Edukimit- Qendra në Prizren, dhe ka marr titullin Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, si dhe Diplomën me Nr.719 të datës 12 shkurt 2019 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 16 nëntor 2018 ka mbaruar studimet master dhe ka marr titullin Master i Shkencave Filologjike. Po ashtu, me rastin e aplikimit i njëjti ka dorëzuar Licencën e Mësimdhënësit të kualifikuar të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me afat vlefshmërie nga data 01.03.2013 deri më datë 01.03.2018.

Nga analizimi i dosjes se kandidatëve fitues rezulton se dy prej tyre, respektivisht kandidatja _____, i dhe kandidati _____, me rastin e aplikimit kanë dorëzuar Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, me afat të skaduar, ndërsa të paktën nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, rezulton se kandidati tjetër fitues, _____, nuk posedon fare Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të sqarimit të rrethanave juridike të krijuara si me lartë e që ndërlidhën me vlefshmërinë e licencave të mësimdhënësve që ju ka skaduar afati e të cilët janë përfshirë në listën e ngushtë dhe rrjedhimisht kanë vazhduar me fazat e mëtejme të rekrutimit, ka kërkuar informatë zyrtar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, se mbi cilën bazë juridike janë vlerësuar këto licenca, ndërsa kjo e fundit, më datë 05.12.2023 ka njoftuar se: *Lidhur me pyetjen tuaj se si kemi bërë vlerësimin e licencave të mësimdhënësve të cilëve ju ka skaduar afati, a ka ndonjë dokument nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si ministri përgjegjëse për lëshimin e licencave lidhur me këtë çështje, ju informojmë se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it me nr.14/2023, për sisteminin e licencave dhe karrierës i cili përcakton: "Licencat e karrierës se mësimdhënësve të lëshuara nga vitet 2012-2022, vazhdojnë për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme*

deri ne realizimin e procesit të brendshme të VPM". Andaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar të gjitha licencat e mësimdhënësve gjatë verifikimit. Si rrjedhojë, me qëllim të vërtetimit të këtij fakti, më datë 17.11.2023 është kërkuar informatë zyrtare nga përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës nëse Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit të njëjtën ditë ka konfirmuar se "Udhëzimi Administrativ ne fjale nuk gjendet i publikuar në ueb portalin e Gazetës Zyrtare, gjithashtu të gjitha aktet të cilat vijnë për publikim në portalin e Gazetës Zyrtare zakonisht publikohen brenda ditës".

Andaj, duke marr parasysh faktin se Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Për me tepër, edhe sikur të ishte i publikuar, i njëjti për shkak të mënyrës se si është nxjerrjes (gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së rekrutimit) nuk do të mund të aplikohet në rrethanat e rastit konkret, ngase do të krijonte situatë diskriminuese në raport me gjithë kandidatët tjerë të cilët kanë poseduar licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, me afat të skaduar, dhe nuk kanë aplikuar apo kanë aplikuar dhe ju ka refuzuar aplikacioni, për shkak të kriterit të konkursit, ngase në shpallje të konkursit decidivisht është kërkuar "Licenca e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës".

Prandaj, duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (e aplikueshme në kohën e zhvillimit të procedurës përkatëse të rekrutimit), ku përcaktohet se: "Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlihen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë", dhe rrjedhimisht, duke qenë se tani më është vërtetuar mjaftueshëm se janë përfshirë në listë të ngushtë, dhe për me tepër janë shpallur fitues edhe kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret formale, sikurse është rasti me kandidaten fituese

_____, të cilët nuk e posedojnë një Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, të vlefshme, apo kandidati tjetër fitues, _____ i cili nuk posedon fare Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, Kolegji i Këshillit konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe si rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke mos respektuar kështu kriteret formale të përcaktuar në konkurs nga vetë organi përkatës që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, dhe për pasojë ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, nisur nga qëndrimet e dhëna si me lartë rezulton se akti i goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimi Nr.1405 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me kandidatet fitues për grupin "Specialit i Arsimit" me numër reference RN00011607, pozita e punës "Inspektor i Arsimit" në SIA-Prizren, janë nxjerr përmes shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, ngase njësia përgjegjëse ka dështuar t'i zbatoj dispozitat që i përkasin fazës së verifikimit paraprak të dokumenteve, dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material kur ka vendosur t'i përfshij në listë të ngushtë edhe kandidatët të cilët nuk kanë poseduar Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me kriteret formale të konkursit dhe si rrjedhojë dispozitat e nenit 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të

Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ashtu që si i tillë ky Vendim, respektivisht Njoftim është i paligjshme në kuptim të nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se procedura e pranimit në shërbimin civil sipas Konkursit me numër reference RN00011607 për grupin "Specialit i Arsimit", pozita e punës "Inspektor i Arsimit" në SIA-Prizren, nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me parimet e pranimit të zyrtareve publikë, siç parashihet me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore", kështu që si rezultat i shkeljeve të evidentuara si me lartë, u vendos që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të anulohet Vendimi me Nr.1405 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror, Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarrë nga faza e verifikimit paraprak deri në publikimin e Njoftimit të datës 12.09.2023, dhe çështja të kthehet në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje në fazën e verifikimit paraprak të dokumenteve në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse, obligohet që në ri-procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi, dhe se vetëm pas konstatimit se kandidatët, duke përfshi këtu edhe ankueset, i plotësojnë kriteret formale të konkursit, të përgatis listën e ngushtë dhe të procedoj me fazat tjera të rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1323/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses.
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - MPB;
- Arkivot të KPMSHCK-së.